


MANUALI I PËRDORIMIT TË KONDICIONERIT SPLIT MODEL



Ky manual udhëzimi përmban informacione të rëndësishme dhe rekomandimet që ne do t'ju kërkojmë t'i zbatoni dhe të merrni rezultatet më të mira nga kondicioneri.

PËRMBAJTJA

HYRJE NË GAZRAT FTOHËS R32/R290-----	1
MASAT E SIGURISË	2
EMËRTIMET E PJESËVE.....	5
EKRANI I NJËSISË SË BRENDSHME	6
FUNKSIONI I EMERGJENCËS & I RINDEZJES AUTOMATIKE	7
PULTI I KOMANDIMIT	8
UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT	12
MBROJTJA	18
MANUALI I INSTALIMIT.....	19
MIRËMBAJTJA	32
ZGJIDHJA E PROBLEMEVE	33

Karakteristikat estetike dhe dimensionale, të dhënat teknike dhe aksesoret e kësaj pajisjeje mund të ndryshohen pa paralajmërim, në përputhje me politikën e shoqërisë për përmirësim të vazhdueshëm të produktit.

INTRODUCTION TO REFRIGERANTS R32&R290

■ Hyrje në gazrat ftohës R32/R290

Gazrat ftohës të përdorur për kondicionerët janë hidrokarbure miqësorë ndaj mjedisit R32 dhe R290. Dy llojet e gazrave ftohës marrin flakë dhe nuk kanë erë. Për më tepër, ata mund të shpërthejnë në kushte të caktuara. Megjithatë, rreziku i marrjes flakë apo i shpërthimit nuk do të ekzistojë nëse ju zbatoni tabelën e mëposhtme që ju tregon se si të instaloni kondicionerin në një dhomë me sipërfaqen e nevojshme dhe si ta përdorni saktësisht.

Krahasuar me gazrat ftohës të zakonshëm, gazrat ftohës R32 & R290 janë miqësorë ndaj mjedisit dhe nuk e shkatërrojnë shtresën e ozonit dhe ato ndikojnë shumë pak në efektin serrë.

■ Kërkesat për sipërfaqen e dhomës për kondicionerët me gazra ftohës R32 & R290

Gazrat ftohës	Kapaciteti (Btu)	Sipërfaqja e dhomës
R32	9K	Mbi 4m ²
	12K	Mbi 4 m ²
	18K	Mbi 15 m ²
	22K/24K	Mbi 25 m ²
R290	9K	Mbi 10 m ²
	12K	Mbi 13 m ²
	18K	Mbi 15 m ²
	22K/24K	Mbi 30 m ²

Paralajmërimë

- Ju lutemi lexojeni manualin para instalimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes.
- Mos përdorni pajisje për të përshpejtuar procesin e shkrirjes apo për ta pastruar kondicionerin, përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- Mos e shponi apo përplasni pajisjen.
- Pajisja ruhet në një dhomë pa burime që funksionojnë vazhdimisht (për shembull: flakë, pajisje gazi apo ngrohëse elektrike funksionale).
- Ju lutemi kontaktoni qendrën më të afërt të shërbimit të pas shitjes në rastet kur nevojitet mirëmbajtje. Gjatë mirëmbajtjes, stafi i mirëmbajtjes duhet të zbatojë me përpikmëri Manualin e Funksionimit që jepet nga prodhuesi dhe ndalohet që kondicioneri të mirëmbahet nga një person që nuk është profesionist.
- Duhet të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe të rregulloreve kombëtare që lidhen me gazin.
- Është e rëndësishme që gazi ftohës të hiqet kur bëhet mirëmbajtja ose kur kondicioneri dërgohet për skrap.



Paralajmërim: Merr flakë & e rrezikshme



Lexoni manualin e përdoruesit



Lexoni manualin e instalimit



Lexoni manualin e shërbimit manual

RREGULLAT E SIGURISË DHE REKOMANDIME PËR INSTALUESIN

- ⚠ Lexojeni këtë manual para se ta instaloni dhe përdorni pajisjen.
- ⚠ Gjatë instalimit të njërive të brendshme dhe të jashtme, fëmijët nuk duhet të lejohen të hyjnë në zonën e punës.
Mund të ndodhin aksidente të paparashikuara.
- ⚠ Sigurohuni që baza e njësisë së jashtme të jetë montuar mirë.
- ⚠ Kontrolloni që të mos hyjë ajër në sistemin e gazit ftohës dhe kontrolloni nëse ka rrjedhje të gazit ftohës kur lëvizni kondicionerin.
- ⚠ Pasi ta instaloni kondicionerin, kryeni një cikël provë dhe mbajini shënim të dhënat e funksionimit.
- ⚠ Siguresa e instaluar te njësia e integruar e kontrollit vlerësohet me T SA / 250V .
- ⚠ Përdoruesi duhet ta mbrojë njësinë e brendshme me anë të një siguresë me kapacitet të përshtatshëm për rrymën maksimale të inputit apo me një pajisje tjetër mbrojtjeje nën ngarkesë.
- ⚠ Sigurohuni që tensioni i rrymës kryesore të përputhet me atë të vulosur te tabela e vlerësimit. Mbajeni çelësin apo spinën e energjisë të pastër. Vendoseni spinën mirë në prizë, duke shmangur kështu rrezikun e një goditjeje elektrike apo flake për shkak të kontaktit të pamjaftueshëm.
- ⚠ Kontrolloni që priza të jetë e përshtatshme për spinën, në të kundërt ndryshojeni prizën.
- ⚠ Pajisja duhet të pajiset me mjetet e nevojshme për t'u shkëputur nga linjat e furnizimit që kanë ndarje të kontakteve në të gjitha shtyllat që ofrojnë shkëputje të plotë në përputhje me kushtet e kategorisë III të mbitensionit dhe këto mjete duhet të integrohen me lidhjet e fiksuara në përputhje me rregullat e lidhjeve.
- ⚠ Kondicioneri duhet të instalohet nga profesionistë apo persona të kualifikuar.

- ⚠ Mos e instaloni pajisjen në një distancë më pak se 50 cm nga substanca që marrin flakë (alkool, etj.) apo nga enë mbajtëse nën trynisi (p.sh: kanaçe me spërkatës aerosol).
- ⚠ Nëse pajisja përdoret në zona ku nuk ka mundësi ajrosjeje, duhet të merren masat për të parandaluar rastet kur rrjedhje të gazit ftohës të mbeten në atë mjedisi dhe të shkaktojnë rrezik zjarri.
- ⚠ Materialet e ambalazhit janë të riciklueshme dhe duhet të hidhen në kosha të ndarë të mbetjeve. Kur jetëgjatësisë së kondicionerit i vjen fundi, dërgojeni te një qendër e posaçme për grumbullimin e mbetjeve.
- ⚠ Kondicionerin përdoreni vetëm siç udhëzohet në këtë manual. Këto udhëzime nuk mbulojnë të gjitha kushtet dhe situatat e mundshme. Ashtu siç edhe me pajisjet elektroshtëpiake, gjithmonë rekomandohet që të përdorni logjikën dhe të jeni të kujdesshëm gjatë instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes.
- ⚠ Pajisja duhet të instalohet në përputhje me rregulloret kombëtare të zbatueshme.
- ⚠ Para se të aksesoni terminalët, të gjitha qarqet duhet të shkëputen nga furnizimi me energji elektrike.
- ⚠ Pajisja instalohet në përputhje me rregulloret kombëtare të lidhjeve.
- ⚠ Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët mbi 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijore dhe mendore apo nga personat që nuk kanë përvojë dhe njohuri, vetëm mbikëqyren apo janë udhëzuar lidhur me përdorimin e pajisjes në mënyrë të sigurt dhe për të kuptuar rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk lejohet të luajnë me pajisjen. Fëmijët nuk lejohet të pastrojnë apo mirëmbajnë kondicionerin pa mbikëqyrje.

RREGULLAT E SIGURISË DHE REKOMANDIME PËR INSTALUESIN

- ⚠ Mos u përpiqni ta instaloni vetëm kondicionerin. Kontaktoni gjithmonë staf teknik të specializuar.
- ⚠ Pastrimi dhe mirëmbajtja duhet të kryhen nga staf teknik i specializuar. Në çdo rast, shkëputni pajisjen nga lidhja kryesore e energjisë elektrike para se ta pastroni apo mirëmbani.
- ⚠ Sigurohuni që tensioni i rrymës kryesore të përputhet me atë të vendosur te tabela e vlerësimit. Mbajeni çelësin apo spinën e energjisë të pastër. Vendoseni spinën mirë në prizë, duke shmangur kështu rrezikun e një shoku elektrik apo flake për shkak të kontaktit të pamjaftueshëm.
- ⚠ Mos e hiqni spinën si mënyrë për të fikur pajisjen kur po funksionon, pasi kjo mund të shkaktojë shkëndijë dhe rrjedhimisht flakë, etj.
- ⚠ Kjo pajisje është krijuar për mjedise shtëpiake dhe nuk duhet të përdoret për qëllime të tjera, si për shembull për tharjen e rrobave, për të freskuar ushqimet, etj.
- ⚠ Materialet e ambalazhit janë të riciklueshme dhe duhet të hidhen në kosha të ndarë të mbetjeve. Kur jetëgjatësisë së kondicionerit i vjen fundi, dërgojeni te një qendër e posaçme për grumbullimin e mbetjeve.
- ⚠ Përdoreni gjithmonë pajisjen me filterin e ajrit të montuar. Përdorimi i kondicionerit pa filtër ajri mund të shkaktojë grumbullim të tepërt të pluhurit apo mbetjeve në pjesët e brendshme të pajisjes, duke shkaktuar mosfunksionim të saj.
- ⚠ Përdoruesi është përgjegjës që pajisja të instalohet nga një teknik i kualifikuar, që duhet të kontrollojë nëse pajisja është tokëzuar në përputhje me legjisllacionin aktual dhe të vendosë një automat termomagnetik.
- ⚠ Bateritë e pultit të komandimit duhet të riciklohen apo hidhen saktësisht. Grumbullimi i baterive për skrap --- Ju lutemi hidhni bateritë si mbetje të grumbulluara bashkiake te pika e aksesueshme e grumbullimit.

- ⚠ Asnjëherë mos u ekspozoni drejtpërdrejtë për një kohë shumë të gjatë ndaj fryrjes së ftohtë të ajrit. Ekspozimi i drejtpërdrejtë dhe i zgjatur ndaj ajrit të ftohtë mund të rrezikojë shëndetin tuaj. Duhet kushtuar shumë kujdes në dhomat me fëmijë, apo njerëz të moshuar ose të sëmurë.
- ⚠ Nëse pajisja nxjerr tym apo lëshon një erë të djegur, fikeni menjëherë dhe kontaktoni me Qendrën e Shërbimit.
- ⚠ Përdorimi i zgjatur i pajisjes në të tilla kushte mund të shkaktojë zjarr ose goditje elektrike. Riparimet duhet të kryhen vetëm nga Qendra Shërbimi të autorizuar nga prodhuesi.
- ⚠ Riparimet e pasakta mund ta ekspozojnë përdoruesin ndaj rrezikut të goditjes elektrike, etj. Nëse parashikoni se nuk do ta përdorni pajisjen për një kohë të gjatë, hiqeni spinën.
- ⚠ Drejtimi i fryrjes së ajrit duhet rregulluar saktësisht.
- ⚠ Mbylleset duhet ta kenë drejtimin për nga poshtë kur kondicioneri është në funksionin ngrohje, ndërsa drejtimi duhet për nga lartë kur është në funksionin e ftohjes.
- ⚠ Kondicionerin përdoreni vetëm në përputhje me udhëzimet e këtij manuali. Këto udhëzime nuk mbulojnë të gjitha kushtet dhe situatat e mundshme. Ashtu siç edhe me pajisjet elektroshtëpiake, gjithmonë rekomandohet që të përdorni logjikën dhe të jeni të kujdesshëm gjatë instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes.
- ⚠ Sigurohuni që pajisja të mos jetë e lidhur me energjinë elektrike nëse nuk do të funksionojë për një kohë të gjatë dhe para se të bëni pastrimin apo mirëmbajtje.
- ⚠ Zgjedhja e temperaturës më të përshtatshme mund të parandalojë dëmtimin e pajisjes.


RREGULLAT E SIGURISË DHE NDALIMET

- ⊖ Mos e përkulni, tërhiqni apo shtypni kabllon, pasi mund të dëmtohet. Dëmtimi i kabllos mund të shkaktojë goditje elektrike apo zjarr. Kabllot e dëmtuar mund të zëvendësohen vetëm nga staf teknik i specializuar .
- ⊖ Mos përdorni zgjatës apo prizë me ndarje.
- ⊖ Mos e prekni pajisjen në rast se e këmbëzbathur keni trupin të lagur. apo
- ⊖ Mos e bllokoni hyrjen apo daljen e ajrit te njësisë së brendshme ose të jashtme. Bllokimi i këtyre hapjeve shkakton zvogëlimin e efikasitetit të funksionimit të kondicionerit, po ashtu mund të shkaktojë edhe mosfunksionime apo dëmtime.
- ⊖ MOS ndryshoni karakteristikat e pajisjes.
- ⊖ Mos e instaloni pajisjen në mjedise ku ajri mund të përmbajë gaz, vaj, squfur apo afër burimeve të nxehtësisë.
- ⊖ Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët mbi 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijore dhe mendore apo nga personat që nuk kanë përvojë dhe njohuri, vetëm nëse i kanë mbikëqyrur apo janë udhëzuar lidhur me përdorimin e pajisjes nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre.
- ⊖ Mos hipni apo mos vendosni objekte të rënda apo të nxehta mbi pajisje.
- ⊖ Mos i lini dritaret apo dyert hapur për shumë kohë kur e keni ndezur kondicionerin.
- ⊖ Mos e drejtoni fryrjen e ajrit nga bimët apo kafshët.
- ⊖ Ekspozimi i drejtpërdrejtë dhe i zgjatuar ndaj fryrjes së ajrit mund të ndikojë negativisht te bimët dhe kafshët.
- ⊖ Mos e vendosni kondicionerin në kontakt me ujin. Mund të dëmtohet izolimi elektrik dhe kështu shkaktohet goditja elektrike.
- ⊖ Mos u ngjisni në ose mos vendosni objekte te njësia e jashtme.
- ⊖ Mos vendosni asnjëherë shkopinj ose objekte të ngjashme te pajisja. Mund të lëndoheni.
- ⊖ Fëmijët duhet të mbikëqyren në mënyrë që të sigurohet që nuk do të luajnë me pajisjen. Nëse dëmtohet kabllot, duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, personi i qendrës së shërbimit apo persona të tjerë të kualifikuar në mënyrë që të shmangët rreziku.

EMËRTIMET E PJESËVE


NJËSIA E BRENDSHME

Nr.	Përshkrimi
1	Paneli ballor
2	Filtri i ajrit
3	Filtër opsional (nëse instalohet)
4	Ekrani LED
5	Marrësi i sinjalit
6	Kapaku i terminalit
7	Jonizues ajri (nëse instalohet)
8	Grilat
9	Butoni i emergjencës
10	Emërtimi për vlerësimin e njësisë së brendshme (pozicioni me ngjijtje i disponueshëm)
11	Mbyllësja për drejtimin e ajrit
12	Pult i komandimit









NJËSIA E JASHTME

Nr.	Përshkrimi
13	Rrjeta e daljes së ajrit
14	Emërtimi i vlerësimit të njësisë së jashtme
15	Kapaku i terminalit
16	Valvula e gazit
17	Valvula e produktit të lëngshëm



Shënim: pamjet e mësipërme janë thjeshtë një paraqitje e pajisjes dhe mbase nuk janë të njëjta me pamjen e njësisë që keni blerë ju.

EKRANI I NJËSISË SË BRENDSHME



No.	Led		Function
1	POWER		Ky simbol bëhet i dukshëm kur njësia është e ndezur
2	SLEEP (NË GJUMË)		Regjimi SLEEP
3	Ekrani i temperaturës (nëse ka) /Kodi i gabimeve		(1) Pulson gjatë operacionit Timer kur kondicioneri funksionon (2)Paraqet kodin e keqfunksionimit kur ndodhin gabime.
4	TIMER (KOHËMATËSI)		Pulson gjatë operacionit Timer.
5	RUN (FUNKSIONAL)		Ky simbol ndizet kur njësia është e ndezur dhe fiket kur njësia është e fikur.

Forma dhe pozicioni i çelësave dhe i treguesve mund të ndryshojë në varësi të modelit, por funksioni është i njëjtë.


FUNKSIONI I EMERGJENCËS & AUTO-RESTART

FUNKSIONI AUTO-RESTART (RINDEZJE AUTOMATIKE)

Pajisja vendoset paraprakisht në funksionin e rindezjes automatike nga prodhuesi. Në rast të shkëputjes së energjisë elektrike, moduli memorizon kushtet e konfigurimit të para shkëputjes. Kur ndizet përsëri energjia elektrike, njësia rindizet automatikisht me të gjitha konfigurimet e mëparshme të ruajtura nga funksioni i memories.

Për të çaktivizuar funksionin RINDEZJE AUTOMATIKE, veproni si më poshtë:


1. Fikeni kondicionerin dhe hiqeni spinën nga priza.
2. Shtypni butonin e emergjencës dhe ndërkohë vendoseni përsëri në prizë.
3. Shtypeni butonin e emergjencës për më shumë se 10 sekonda derisa të dëgjoni katër bip-e të shkurtra nga njësia. Funksioni RINDEZJE AUTOMATIKE nuk është i aktivizuar.
 - Për të aktivizuar funksionin RINDEZJE AUTOMATIKE, ndiqni të njëjtën procedurë deri kur të dëgjoni tre bip-e të shkurtra nga njësia.



FUNKSIONI I EMERGJENCËS

Nëse pultu i komandimit nuk funksionon ose nëse nevojitet mirëmbajtje, ndiqni hapat e mëposhtëm: hapni dhe ngrini panelin ballor deri në një kënd për të arritur butonin e emergjencës.




1. Një shtypje e vetme e butonit të emergjencës (një bip) mjafton për të filluar regjimin e detyruar të FTOHJES
 2. Dy shtypje të butonit të emergjencës brenda 3 sekondave (dy bip-e) fillojnë regjimin e detyruar të NGROHJES
 3. Për të fikur njësinë, thjesht shtypeni përsëri butonin (një bip i vetëm i gjatë).
 4. Pas 30 minutash në regjimin e detyruar, kondicioneri do të fillojë të punojë automatikisht në 23 °C në regjimin e ftohjes, me shpejtësi auto të ventilatorit.
- Funksioni FEEL përshkruhet në faqen 16.




⚠ Forma dhe pozicioni i çelësave dhe i treguesve mund të ndryshojë në varësi të modelit, por funksioni është i njëjtë.


Vërejtje: presioni i jashtëm statik i pompave të nxehtësisë është 0 Pa për të gjitha modelet.

PULTI I KOMANDIMIT










No.	Buttor	Function
1	▲ (TEMP UP)	Shtypeni për të rritur temperaturën/konfigurimin e kohës.
2	▼ (TEMP DN)	Shtypeni për të ulur temperaturën/konfigurimin e kohës.
3	Ⓞ or ON/OFF	Shtypeni për ta ndezur apo fikur kondicionerin.
4	FAN	Për të zgjedhur shpejtësinë e ventilatorit auto/ulët/mesëm/lartë
5	TIMER	Shtypeni për të vendosur kohëmatësin auto-fikur
6	SLEEP	Për të aktivizuar funksionin SLEEP
7	ECO	Shtypeni këtë buton për të aktivizuar / çaktivizuar funksionin ECO që mundëson që njësia të vendosë automatikisht operacionin për ruajtjen e energjisë
8	MODE	Për të zgjedhur regjimin e funksionimit
9	SUPER / TURBO	Shtypeni këtë buton për të aktivizuar / çaktivizuar funksionin SUPER që mundëson që njësia të arrijë temperaturën e vendosur paraprakisht brenda një kohe sa më të shkurtër.
10	SWING X /  SWING ◀▶ / L-R	Për të aktivizuar ose çaktivizuar lëvizjen e grilave horizontale. (Nëse është e zbatueshme)
	SWING / SWING Y /  SWING ⬆ / U-D	Për të aktivizuar ose çaktivizuar lëvizjen e grilave vertikale.
11	CLOCK	Kur shtypni këtë buton, ora do të pulsojë, më pas, përmes ▲ dhe ▼ mund të rregulloni orën (me një të shtypur rregulloni një minutë; dhe nëse vazhdoni ta shtypni, ora ndryshon shpejt), pasi ta rregulloni sipas dëshirës suaj, ju lutemi shtypeni përsëri këtë buton për të rregulluar orën. (Nëse është e zbatueshme)
12	DISPLAY	Për ta ndezur/fikur ekranin. (Nëse është e zbatueshme)
13	HEALTHY / HEALTH / PLASMA	Për të ndezur/fikur funksionin HEALTH. Ky buton kontrollon jonizuesin apo gjeneruesin e plazmës. (Nëse është e zbatueshme)
14	3D	Kur shtypni 3D , grilat horizontale dhe vertikale lëkunden së bashku në të njëjtën kohë. (Nëse është e zbatueshme)
15	RESET	Për të rindezur PULTIN E KONTROLLIT. (Nëse është e zbatueshme)
16	ANTI-MILDEW / MILDEW	Për të aktivizuar funksionin ANTI - MILDEW (kundër mykut). (Nëse është e zbatueshme)
17	ANTI-MOSQUITO	Për të aktivizuar funksionin ANTI- MOSQUITO (kundër mushkonjave). (Nëse është e zbatueshme)
18	Mute	Për të aktivizuar funksionin Mute (pa tingull). (Nëse është e zbatueshme)
19	 (MODE+TIMER)	Për të aktivizuar funksionin Child Lock (Miqësor ndaj fëmijëve) kur shtypni butonat MODE dhe TIMER në të njëjtën kohë. (Nëse është e zbatueshme)
20	AH	Për të aktivizuar funksionin ngrohje 8°C(pa tingull). (Nëse është e zbatueshme)
21	I FEEL	Për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin I FEEL . Kondicioneri do ta rregullojë temperaturën e dhomës duke u bazuar në temperaturën (0 °C ~50 °C) rreth pultit të komandimit. Ky funksion përfundon 2 orë pasi aktivizohet. (Nëse është e zbatueshme)
22	I SET	Ndizeni/fikeni funksionin I SET, hollësitë shikojini në faqen 17
23	CLEAN	Ndizeni/fikeni funksionin self-clean (vetëpastrim), hollësitë shikojini në faqen 17 Shënim: Mos e shtypni shpesh butonin. Rekomandohet që të shtypet çdo tre muaj.

 Pamja dhe disa funksione të pultit të komandimit mund të jenë ndryshe.

 Njësia e konfirmon marrjen e saktë sa herë shtypet një buton me një tingull “bip”.

 HEALTH/MUTE/CLEAN/IFEEL/I SET, SWING(majtas dhe djathtas), këto janë butona opsionale. Do të dëgjoni një tingull “bip” kur e shtypni. Megjithatë, kërkohet ndjesë pasi modeli i përshkruar nuk e ka këtë funksion.

REMOTE CONTROLLER


























































⚠ Pamja dhe disa funksione të pultit të komandimit mund të jenë ndryshe.

⚠ Forma dhe pozicioni i çelësve dhe i treguesve mund të ndryshojë në varësi të modelit, por funksioni është i njëjtë. Forma dhe pozicioni i rastit tuaj është kryesor.

PULTI I KOMANDIMIT

Ekрани i pultit të komandimit Kuptimi i simboleve tek ekрани LCD

Nr	Simbolet	Kuptimi
1	 or 	Treguesi i regjimit FEEL
2		Treguesi COOLING
3	 or 	Treguesi DEHUMIDIFYING (HEQJA E LAGËSHITRËS)
4		Treguesi funksionit FAN ONLY (VETËM VENTILATOR)
5		Treguesi HEATING
6	 or 	Treguesi SIGNAL RECEPTION (MARRJA E SINJALIT)
7	 or  or  or 	Treguesi TIMER OFF (KOHËMATËSI FIKUR)
8	 or  or  or 	Treguesi TIMER ON (KOHËMATËSI NDEZUR)
9	 or  or  or 	Treguesi AUTO FAN (VENTILATOR AUTO)
10	 or  or  or 	Treguesi LOW FAN SPEED (SHPEJTËSIA E ULËT E VENTILATORIT)
11	 or  or  or 	Treguesi MIDDLE FAN SPEED (SHPEJTËSIA E MESME E VENTILATORIT)
12	 or  or  or 	Treguesi HIGH FAN SPEED (SHPEJTËSIA E LARTË E VENTILATORIT)
13	QUIET or  or  or  or 	Treguesi SLEEP
14		Treguesi COMFORTABLE SLEEP (opsional) (GJUMË I REHATSHËM)
15		Treguesi FEEL (opsional)
16	 or  or  or 	Treguesi FLAP SWING (LËKUNDJA E MBYLLËSVE)
17		Treguesi FLAP dhe grilat SWING
18	 or TURBO or POWERFUL	Treguesi SUPER
19	 or  or 	Treguesi HEALTHY (SHËNDETSHËM)
20	 or ECO or 	Treguesi ECO
21		Treguesi ANTI-MILDEW
22	 or 	Treguesi BATTERY
23		Treguesi CLOCK
24		Treguesi MUTE

Ndërrimi i baterive

Hiqni kapakun e pasmë të baterive nga pulti i komandimit duke e rrëshqitur në drejtimin e shigjetës.

Vendosini bateritë sipas drejtimit (+dhe -) të treguar në pultin e komandimit.

Rivendoseni kapakun e baterive duke e rrëshqitur në vend.



Përdorni 2 bateri LRO 3 AAA (1.5V). Mos përdorni bateri të rikarikueshme. Kur të mos dalë më ekrani, ndërrojeni bateritë e vjetra me të reja të të njëjtit tip.

Mos i hidhni bateritë si mbetje bashkiake të pakategorizuara. Grumbullimi i të tilla mbetjeve duhet të bëhet i ndarë, pasi trajtimi i veçantë është i nevojshëm.

Referojuni fotografisë 1:

- Kur hapni kapakun e baterive, mund të shikoni çelësin DIP në pjesën e pasme të kapakut 1

Çelësi DIP në pozicionin	Funksioni
°C	Pulti i komandimit rregullohet në gradë celsius
°F	Pulti i komandimit rregullohet në gradë fahrenheit,
Cool	Pulti i komandimit rregullohet vetëm në regjimin e ftohjes
Heat	Pulti i komandimit rregullohet në regjimin e ftohjes dhe ngrohjes



- SHËNIM: Pasi të rregulloni funksionin, duhet të hiqni bateritë dhe të përsërisni procedurën e përshkruar.

Referojuni fotografisë 2:

Kur vendosni bateritë për herë të parë në pultin e komandimit apo nëse i ndërtoni, duhet ta programoni pultin e komandimit për vetëm ftohje apo për ftohje dhe ngrohje.




Kur vendosni bateritë, simbolet *(COOL ■) dhe

*(HEAT ■) fillojnë të pulsojnë. Nëse shtypni një buton çfarëdo kur jepet simboli *(COOL ■), pulti i komandimit rregullohet vetëm në regjimin e ftohjes. Nëse shtypni një buton çfarëdo kur jepet simboli *(HEAT ■), pulti i komandimit rregullohet në regjimin e ftohjes dhe të ngrohjes.

SHËNIM: nëse e vendosni pultin e komandimit në regjimin e ftohjes nuk do të jetë e mundur që të aktivizohet funksioni i ngrohjes në njësitë me pompën e ngrohjes. Duhet t'i hiqni bateritë dhe ta përsërisni procedurën e përshkruar më lart.

- Drejtojeni pultin e komandimit nga kondicioneri.
- Sigurohuni që të mos ketë objekte ndërmjet pultit të komandimit dhe marrësit të sinjalit në njësinë e brendshme.
- Mos e lini asnjëherë pultin e komandimit në diell.
- Mbajeni pultin e komandimit të paktën 1 m larg nga televizori apo pajisje të tjera elektronike.


Rekomandimet për lokalizimin dhe përdorimin e mbajtësit të pultit të komandimit (nëse ka). Pulti i komandimit duhet të mbahet në një mbajtës të montuar në mur.



UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT

Ajri i thithur nga ventilatori hyn nga rrjeta dhe kalon përmes filtrit, më pas ftohet/i hiqet lagështira ose ngrohet përmes shkëmbyesit të nxehtësisë.

Drejtimi daljes së ajrit motorizohet lart-poshtë nga mbyllëset dhe lëvizet manualisht djathtas dhe majtas nga grilat vertikale. Për modele të caktuara, grilat vertikale mund të jenë të kontrolluara edhe me motor.



KONTROLLI "SWING" I DREJTIMIT TË AJRIT

SWING



Drejtimi i daljes së ajrit shpërndahet në mënyrë uniforme në dhomë.

Drejtimi i ajrit mund të pozicionohet në performancën optimale.

Çelësi SWING apo SWING ^v aktivizon regjimin "FLAP".

Drejtimi i ajrit rregullohet nga lart poshtë. Në mënyrë që të garantohet shpërndarja e njëtrajtshme në dhomë.

Çelësi SWING > aktivizon grilat e motorizuara, drejtimi i ajrit rregullohet nga majtas në djathtas.

(Funksion opsional, në varësi të modelit)

Në regjimin e ftohjes, orientojini fletët në drejtim horizontal;




Në regjimin e ngrohjes, orientojini fletët për nga poshtë pasi ajri ka tendencën që të ngrihet lart;

Grilat pozicionohet manualisht dhe vendosen poshtë fletëve. Ato lejojnë drejtimin e ajrit majtas ose djathtas.

⚠ Δ Këto rregullime duhen kryer kur pajisja të jetë e fukur.

⚠ Δ Mos i pozicionon asnjëherë fletët manualisht, pasi mekanizmi delikat mund të dëmtohet seriozisht!

⚠ Δ Mos vendosni asnjëherë gishtat, shkopinj, apo objekte të tjera në ventilatorët e hyrjes dhe daljes së ajrit. Ky kontakt i drejtëpërdrejtë mund të shkaktojë lëndime të paparashikuara.



UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT

REGJIMI I FTOHJES




) Funkzioni i ftohjes e lejon kondicionerin që të ftohë dhomën dhe të zvogëlojë lagështirën në të njëjtën kohë.

Për të aktivizuar funksionin e ftohjes (COOL), shtypni butonin MODE deri kur të dalë simboli ❄️ (COOL ■) në ekran.

Funksioni i ftohjes aktivizohet duke vendosur butonin “▲” ose “▼” në një temperaturë më të ulët se ajo e dhomës.

Në mënyrë që të optimizohet funksioni i kondicionerit, rregullojeni temperaturën (1), shpejtësinë (2) dhe drejtimin e ajrit duke shtypur butonin e treguar.



REGJIMI I NGROHJES



Funksioni i ngrohjes e lejon kondicionerin që ta ngrohë dhomën.


Për të aktivizuar funksionin e ngrohjes (HEAT), shtypni butonin MODE, deri kur të dalë simboli ☀️ (HEAT ■) në ekran.

Me butonin “▲” ose “▼” vendosni një temperaturë më të lartë se ajo e dhomës.

Në mënyrë që të optimizohet funksioni i kondicionerit, rregullojeni temperaturën (1), shpejtësinë (2) dhe drejtimin e ajrit duke shtypur butonin e treguar.


⚠️ Nëse pajisja ka një ngrohëse elektrike, që vonon ndezjen e pajisjes me disa sekonda, në mënyrë që të sigurohet nxjerrja e menjëhershme e ajrit të ngrohtë (opsionale, varet nga modeli).

⚠️ Në regjimin HEATING, pajisja mund të aktivizojë një cikël shkrirjeje, që është thelbësor për pastrimin e brymës në kondencator, në mënyrë që ta vërë përsëri në funksionim regjimin e shkëmbimit të nxehtësisë. Zakonisht kjo procedurë zgjat rreth 2-10 minuta gjatë shkrirjes, apo regjimit të ndalimit të ventilatorit të njësisë së brendshme. Pasi bën shkrirjen, vazhdon automatikisht te regjimi i NGROHJES.



UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT

TIMER MODE----TIMER ON

ON TIMER  Për të vendosur kohëzgjatjen e kondicionerit

Për të programuar ndezjen automatike, pajisja duhet të jetë e fikur.

Shtypni **TIMER** për orën e parë, vendosni temperaturën duke shtypur butonin “▲” ose “▼”;

Shtypni **TIMER** për orën e dytë, vendosni temperaturën duke shtypur butonin “▲” ose “▼”;


Shtypni **TIMER** për orën e tretë, konfirmoni konfigurimin, pastaj koha e çlodhjes deri në ndezjen e radhës automatike shfaqen në ekran.

Shënim!


Para se të caktoni kohëzgjatjen: programoni regjimin në punë me butonin **MODE** (2) dhe shpejtësinë e ventilatorit me butonin **FAN** (3). Fikeni kondicionerin (me çelësin **ON/OFF**).

Shënim: për të anuluar funksionin e caktuar, shtypni përsëri butonin **TIMER**.

Shënim: Në rast se pajisja është fikur, duhet ta ndizni përsëri **TIMER**




Indoor display

OFF TIMER  Për të vendosur fikjen automatike të kondicionerit

Fikja e kronometruar programohet duke shtypur **TIMER**. Kohën e çlodhjes vendoseni duke shtypur butonin “▲” ose “▼”, deri kur koha e paraqitur të përputhet me kërkesën tuaj, më pas shtypni **TIMER**.


Shënim: për të anuluar funksionin e caktuar, shtypni përsëri butonin **TIMER**.

Shënim: Në rast se pajisja është fikur, duhet ta fikni përsëri **TIMER**



Indoor display

 Shënim: Funksioni **TIMER** mund të vendoset në intervale gjysmë orësh.



Ekran i brendshëm

OPERATING INSTRUCTIONS

REGJIMI FAN (VENTILATOR)

FAN ■




Kondicioneri funksionon vetëm me ventilator.

Për të zgjedhur regjimin FAN, shtypni MODE deri kur të dalë (FAN) në ekran.

Kur shtypni butonin FAN, shpjëtesia ndryshon si vijon: E ulët/ e mesme/ e lartë/auto, në regjimin FAN.

Pulti i komandimit ruan shpejtësinë e zgjedhur në regjimin e mëparshëm të funksionimit.

Në regjimin FEEL (automatik) kondicioneri e zgjedh automatikisht shpejtësinë e ventilatorit dhe regjimin e funksionimit (FTOHJE apo NGROHJE).




REGJIMI DRY (I THATË)

DRY ■



Ky funksion zvogëlon lagështirën e ajrit për ta bërë dhomën më të rehatshme.

Për të zgjedhur regjimin DRY mode, shtypni MODE deri kur të dalë (DRY ■) në ekran. Një funksion automatik për alternimin e cikleve të ftohjes dhe ventilatorin e ajrit është i aktivizuar.



OPERATING INSTRUCTIONS

REGJIMI FEEL




Regjim automatik.

Për të aktivizuar regjimin FEEL (automatik) të funksionit, shtypni butonin MODE në pultin e komandimit deri kur të shfaqet (FEEL ■) në ekran.

Në regjimin FEEL, shpejtësia e ventilatorit dhe temperatura vendosen automatikisht në varësi të temperaturës së dhomës (testuar nga sensori i temperaturës që është pjesë e njësisë së brendshme).

Temp. e mjedisit	Regjimi i funksionit	Temp. automatike
20°C-26°C	DRY	18°C
>26°C	COOL	23°C

Për të optimizuar funksionin e kondicionerit, rregullojeni temperaturën (vetëm + 12°C)(1), shpejtësinë(2) dhe drejtimin e fryrjes së ajrit (3) duke shtypur butonat e treguar



REGJIMI SLEEP




Për të aktivizuar regjimin SLEEP të funksionit butonin SLEEP në pultin e komandimit deri kur të dalë

simboli (AUTO QUIET) në ekran.

Funksioni “ SLEEP ” e rregullon automatikisht temperaturën për ta bërë dhomën më të rehatshme gjatë natës. Në regjimin e ftohjes dhe të thatë, temperatura e vendosur do të rritet automatikisht me 1°C çdo 60 minuta, për të arritur një ngritje me 2°C gjatë 2 orëve të para të funksionimit.

Në regjimin e ngrohjes, temperatura e vendosur ulet gradualisht me 2°C gjatë 2 orëve të para të funksionimit.

Pas 10 orësh funksionimi në regjimin SLEEP, kondicioneri fiket automatikisht.




Ekran i brendshëm

UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT

Funksioni I SET (Opsional)

Përshtateni temperaturën (COOLING/HEATING), në secilin prej regjimeve COOLING/HEATING/FAN/DRY, dhe lëvizini fletët sipas zgjedhjes, më pas mbani të shtypur butonin "I SET" për 3 sekonda, derisa në ekran të shfaqet "AU" dhe sfondi i ekranit të ndriçohet dhe pulsi i komandimit do t'i "kujtojë" këto hapa. Ju mund ta vendosni në gjendjen e mëparshme duke përsëritur veprimet e mësipërme.

Shtypni butonin "I SET" në secilin prej regjimeve COOLING/HEATING/FAN/DRY, për ta aktivizuar këtë funksion, më pas kondicioneri do të punojë sipas funksionit të zgjedhur dhe do të shihni në ekranin e pulsit të komandimit funksionin AU duke pulsuar. Për ta anuluar këtë funksion shtypeni përsëri këtë buton ose butona të tjerë.



Funksioni Self-Clean (Opsional)

1. Ky funksion ndihmon në largimin e pluhurave të mbledhur, bakterieve, etj. nga aparati i avullimit.
2. Shtypni butonin "CLEAN" për ta vendosur këtë funksion në çdo regjim dhe në ekranin e njësisë së brendshme do të shfaqet "CL".
3. Ky funksion do të veprojë për rreth 30 minuta, dhe do të vendoset në regjimin përpara këtij funksioni. Ju mund të shtypni "ON/OFF" ose "Mode", për ta anuluar këtë funksion gjatë procesit.
Kur funksioni të ketë përfunduar ose të jetë anuluar, ju do të dëgjoni 2 tinguj.
4. Është normale nëse ka ndonjë zhurmë gjatë procesit, pasi materialet plastike zgjerohen nga nxehtësia dhe mbliidhen nga i ftohti.
5. Ju sugjerojmë që ta përdorni këtë funksion sipas kushteve të mëposhtme të ambientit, për të shmangur disa veçori të mbrojtjes së sigurisë.
Njësia e brendshme Temp<30 °C
Njësia e jashtme 5 °C<Temp<30 °C
6. Ju sugjerojmë që ta përdorni këtë funksion për 3 muaj.



UDHËZIMET E FUNKSIONIMIT

Temperatura e funksionimit


Kondicioneri është i programuar për kushte jetese të rehatshme dhe të përshtatshme si më poshtë dhe nëse përdoret jashtë këtyre kushteve, mund të hyjnë në zbatim disa veçori të mbrojtjes së sigurisë.


Vendosni parametrat e duhur:

Regjimi Temperatura	Temp. e ftohjes	Temp. e ngrohjes	Temp. e tharjes
Temperatura e dhomës	17°C ~32°C	0°C ~27°C	18°C~32°C
Temperatura e jashtme	0°C ~43°C Për klimë T1	-7°C~24°C	0°C~50°C
	0°C ~52°C Për klimë T3		

Kondicioner me inverter:

Regjimi Temperatura	Temp. e ftohjes	Temp. e ngrohjes	Temp. e tharjes
Temperatura e dhomës	17°C ~32°C	0°C ~30°C	10°C~32°C
Temperatura e jashtme	0°C ~53°C	-15°C~30°C	0°C~50°C
	-15°C ~53°C Për modele me sistem ftohjeje në temperaturë të ulët		

 Njësia nuk funksionon menjëherë pasi të ndizet, fiket ose pasi të jetë ndërruar regjimi gjatë punës. Ky është një veprim normal vetëmbrojtjeje, ju duhet të prisni për rreth 3 minuta.

 Kapaciteti dhe efektshmëria janë në përputhje me testin e kryer gjatë funksionimit të plotë*. *Kërkoet shpejtësi më e lartë e motorit të ventilatorit të brendshëm dhe kënd i hapur maksimal i fletëve dhe reflektorëve.

■ Për t'u marrë parasysh

- Kondicioneri që do të blihi duhet të instalohet nga stafi profesionist dhe "Installation manual" (Manuali i përdorimit) përdoret vetëm nga stafi profesionist për instalim! Specifikat e instalimit duhet të jenë subjekt i rregulloreve tona të shërbimit të pas shitjes.
- Gjatë mbushjes së gazit ftohës që merr flakë, çdo veprim i gabuar mund të shkaktojë dëmtime të rënda, si dëmtime për trupin e njeriut dhe dëmtime të objekteve të tjera.
- Pas përfundimit të instalimit duhet bërë testi i rrjedhjes.
- Është e domosdoshme që të kryhet kontrolli i sigurisë përpara mirëmbajtjes ose riparimit të kondicionerit, duke përdorur gazin ftohës që merr flakë, për t'u siguruar që rreziku nga flakët të pakësohet sa më shumë të jetë e mundur.
- Është e nevojshme që makineria të vihet në punë nën një procedurë kontrolli, për t'u siguruar që çdo problem nga gazi ftohës që merr flakë ose tubi i avullimit gjatë funksionimit të pakësohet në minimum.
- Kërkesat për peshën totale të gazit ftohës të mbushur dhe hapësira e dhomës ku do të vendoset kondicioneri (gjenden në Tabelën GG.1 dhe GG.2)



Ngarkesa maksimale dhe hapësira minimale

$m_1 = (4 \text{ m}^3) \cdot \text{LFL}$, $m_2 = (26 \text{ m}^3) \cdot \text{LFL}$, $m_3 = (130 \text{ m}^3) \cdot \text{LFL}$

Aty ku *LFL* është limiti më i ulët i marrjes së flakëve në kg/m^3 ; R290 *LFL* është $0.038 \text{ kg}/\text{m}^3$; R32 *LFL* është $0.306/\text{m}^3$. Për pajisjet me sasi ngarkese $m_1 < M < m_2$

Ngarkesa maksimale në dhomë duhet të jetë në përputhje, si vijon: $m_{\text{max}} = 2.5 \times (\text{LFL})^{(5/4)} \times h_0 \times (A)^{1/2}$

Hapësira minimale e nevojshme nga dyshemeja Amin për të instaluar pajisjen me

ngarkesë të gazit ftohës *M* (kg)m, duhet të jetë në përputhje me: $A_{\text{min}} = (M / (2.5 \times (\text{LFL})^{(5/4)} \times h_0))^2$

Ku:

m_{max} ngarkesa maksimale e lejueshme në dhomë, në kg;

M sasia e ngarkesës së gazit ftohës në pajisje, në kg;

A_{min} është hapësira minimale e nevojshme në dhomë, në m^2 ;

A është hapësira e dhomës, në m^2 ;

LFL limiti më i ulët i marrjes së flakëve, në kg/m^3 ;

h_0 lartësia e instalimit të pajisjes, në metra për përllogaritjen m_{max} ose A_{min} 1.8 m për montim në mur;

Tabela GG.1 — Ngarkesa maksimale (kg)

Kategoria	LFL (kg/m ³)	h ₀ (m)	Hapësira nga dyshemeja (ħġ)						
			4	7	10	15	20	30	50
R290	0.038	0.6	0.05	0.07	0.08	0.1	0.11	0.14	0.18
		1	0.08	0.11	0.13	0.16	0.19	0.2	0.3
		1.8	0.15	0.2	0.24	0.29	0.34	0.41	0.53
		2.2	0.18	0.24	0.29	0.36	0.41	0.51	0.65
R32	0.306	0.6	0.68	0.9	1.08	1.32	1.53	1.87	2.41
		1	1.14	1.51	1.8	2.2	2.54	3.12	4.02
		1.8	2.05	2.71	3.24	3.97	4.58	5.61	7.254
		2.2	2.5	3.31	3.96	4.85	5.6	6.86	8.85

Tabela GG.2 — Hapësira minimale e dhomës (m²)

Kategoria	LFL (kg/m ³)	h ₀ (m)	Sasia e ngarkesës (<i>M</i>) (kg)						
			Hapësira minimale e dhomës (m ²)						
R290	0.038		0.152kg	0.228 kg	0.304 kg	0.456 kg	0.608 kg	0.76 kg	0.988 kg
		0.6		82	146	328	584	912	1514
		1		30	53	118	210	328	555
		1.8		9	16	36	65	101	171
		2.2		6	11	24	43	68	115
R32	0.306		1.224 kg	1.836 kg	2.448 kg	3.672 kg	4.896 kg	6.12 kg	7.956 kg
		0.6		29	51	116	206	321	543
		1		10	19	42	74	116	196
		1.8		3	6	13	23	36	60
		2.2		2	4	9	15	24	40

Parimet e Sigurisë gjatë Instalimit

1. Vendi i Sigurisë



Ndalohen Flakët



Ajrosja është e Nevojshme

2. Siguria e Funkionimit Ndalohen Flakët



Elektriciteti statik



Duhet veshur rrobat mbrojtëse dhe dorezat antistatike



Mos përdorni telefonin celular

3. Siguria gjatë Instalimit

O Detektori i rrjedhjes së gazit ftohës

O Vendndodhja e saktë e instalimit



Te figura në të majtë gjendet skema e detektorit të rrjedhjes së gazit ftohës.

Ju lutemi, vini re se:

1. Instalimi duhet të bëhet në një ambient me ajrosje të mirë.
2. Vendndodhja për instalimin dhe mirëmbajtjen e kondicionerit, duke përdorur Gazin Ftohës R290, nuk duhet të jetë pranë burimeve të zjarrit ose saldimit, tymit, furrave për tharje ose çdo burimi tjetër nxehtësie më i lartë se 370°C, për shkak se shkakton zjarr lehtësisht; vendndodhja për instalimin dhe mirëmbajtjen e kondicionerit, duke përdorur Gazin Ftohës R290, nuk duhet të jetë pranë burimeve të zjarrit ose saldimit, tymit, furrave për tharje ose çdo burimi tjetër nxehtësie më i lartë se 548°C, për shkak se shkakton zjarr lehtësisht.
3. Gjatë instalimit të një kondicioneri, është e nevojshme që të merren masat e duhura antistatike, si për shembull: përdorni veshje dhe/ose doreza antistatike.
4. Është e nevojshme që për instalimin dhe mirëmbajtjen të zgjidhet një vend i përshtatshëm, ku tubi për hyrjen e ajrit dhe tubi për daljen e ajrit i njëjtit të brendshme dhe të jashtme të mos jetë i rrethuar nga pengesa të ndryshme ose pranë çdo burimi nxehtësie ose mjedisi ku merr lehtësisht flakë dhe/ose shpërthyes.
5. Nëse njësia e brendshme pëson rrjedhje të gazit ftohës gjatë instalimit, është e nevojshme që valvula e njësisë së jashtme të fiket menjëherë dhe i gjithë stafi të dalë jashtë, derisa gazi ftohës të ketë rrjedhur plotësisht për 15 minuta. Nëse produkti dëmtohet, është e domosdoshme që ai të dërgohet në stacionin e mirëmbajtjes dhe është e ndaluar që tubi i gazit ftohës të saldohet, ose të kryhen ndërhyrje të tjera në vendndodhjen e përdoruesit.
6. Është e nevojshme që të zgjidhet vendi ku tubi i hyrjes së ajrit dhe tubi i daljes së ajrit të njësisë së brendshme të jenë në nivel të barabartë.
7. Është e nevojshme që të shmangen vendet ku ndodhen produktet e tjera elektrike, spinat dhe prizat, kontrabufeja e kuzhinës, shtrati, divani dhe objekte të tjera të çmuara, poshtë dy kontureve të të dy krahëve të njësisë së brendshme.


Mjete të veçanta

Emri i mjetit	Kushtet e përdorimit
Pompë e vogël për heqjen e vakumit	Pompa e heqjes së vakumit duhet të jetë kundër shpërthimeve; mund të sigurojë precizion të sigurt dhe këndi i vakumit duhet të jetë më i ulët se 10Pa.
Pajisja mbushëse	Pajisja duhet të jetë një pajisje e veçantë mbushëse kundër shpërthimeve; përdoreni me precizion të plotë dhe devijimi i mbushjes duhet të jetë më pak se 5g .
Detektori kundra	Ajo duhet të kalibrohet rregullisht; dhe norma vjetore e rrjedhjes nuk duhet t'i kalojë 10g.
rrjedhjes Detektori i përqendrimit	<p>A) Vendi i mirëmbajtjes duhet të jetë i pajisur me një detektor për përqendrimin e gazit ftohës që merr flakë i llojit të palëvizshëm dhe i lidhur me një sistem alarmi mbrojtës; marzhi i gabimit nuk duhet të jetë më shumë se 5%.</p> <p>B) Vendi i instalimit duhet të jetë i pajisur me një detektor për përqendrimin e gazit ftohës që merr flakë i llojit të lëvizshëm, që mund të përballojë një sistem alarmi me audio dhe video me dy nivele; marzhi i gabimit nuk duhet të jetë më shumë se 10%.</p> <p>C) Detektorët e përqendrimit duhet të kalibrohen rregullisht.</p> <p>D) Përpara se të përdorni detektorët e përqendrimit është e nevojshme që të kontrolloni dhe të konfirmoni funksionet.</p>
Matësi i presionit	<p>A) Matësit e presionit duhet të kalibrohen rregullisht.</p> <p>B) Matësi i presionit i përdorur për Gazin Ftohës 22 mund të përdoret për Gazin Ftohës R290 dhe R161; matësi i presionit i përdorur për Gazin Ftohës R410A mund të përdoret për Gazin Ftohës 32.</p>
Fikësja e zjarrit	Gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes së një kondicioneri, është e nevojshme që të mbani një fikëse zjarri. Në vendin e mirëmbajtjes, duhet të ketë dy ose më shumë lloje fikësesh zjarri: fikëse me dioksid karboni dhe shkumë dhe se këto fikëse duhet të vendosen në pozicione të përcaktuara, me etiketa që lexohen dhe arrihen lehtësisht .

MANUALI I INSTALIMIT---Përzgjedhja e vendit të instalimit

NJËSIA E BRENDSHME


- Njësia e brendshme duhet të instalohet në një mur të fortë që nuk rrezikon të tronditet.
- Portat e jashtme dhe të brendshme të pajisjes nuk duhet të bllokohen: ajri duhet të shpërndahet në të gjithë dhomën.
- Mos e instaloni njësinë pranë burimeve të zjarrit, avullit, ose gazit që merr flakë.
- Njësia duhet të instalohet pranë një spine elektrike ose një qarku, brenda hapësirës vetjake të përdoruesit.
- Njësia nuk duhet të instalohet aty ku ekspozohet drejtpërdrejt me dritën e diellit.
- Përzgjidhni një vend ku uji i kondensuar mund të kullojë shpejt, dhe ku mund të lidhet më lehtësisht me njësinë e jashtme.
- Kontrolloni makinerinë e funksionimit rregullisht dhe rezervoni hapësirat e nevojshme, siç tregohet në figurë.
- Përzgjidhni një vend ku filtri mund të hiqet lehtësisht.





Vendi minimal që duhet rezervuar (mm), siç tregohet në figurë

NJËSIA E JASHTME

- Mos e instaloni njësinë e jashtme pranë burimeve të zjarrit, avullit, ose gazit që merr flakë.
- Mos e instaloni njësinë në vende me shumë erë ose pluhura.
- Mos e instaloni njësinë në vende ku shpesh kalojnë njerëz. Përzgjidhni një vend ku tingulli i shkarkimit dhe i funksionimit të ajrit nuk do t'i shqetësojë fqinjët.
- Njësia nuk duhet të instalohet aty ku ekspozohet drejtpërdrejt me dritën e diellit (në të kundërt, përdorni mbrojtje, nëse është e nevojshme, por që të mos ndërhyjë me kalimin e ajrit).
- Rezervojini hapësirat që ajri të kalojë lirisht, siç tregohet në figurë.
- Instalojeni njësinë e jashtme në një vend të sigurt dhe të mbrojtur.
- Nëse njësia e jashtme mund të tronditet, vendosni rondele gome në këmbët e njësisë.



Skema e instalimit



Blerësi duhet të sigurohet që personi dhe/ose kompania që merret me instalimin, mirëmbajtjen ose riparimin e kondicionerit të jenë të kualifikuar dhe me përvojë në produktet me gaz ftohës.

MANUALI I INSTALIMIT---Instalimi i njësisë së brendshme

Përpara instalimit, vendosni për pozicionin e vendosjes së njësisë së brendshme dhe të jashtme, duke marrë parasysh hapësirën e rezervuar minimale rreth njësisë

⚠ Mos e instaloni kondicionerin në një dhomë me lagështirë, si për shembull, në banjë ose lavanderi, etj.

⚠ Vendi i instalimit duhet të jetë 250cm larg nga dyshemeja ose më shumë.

Për ta instaluar, vijoni si më poshtë:

Instalimi i pllakës montuese

1. Panelin e pasmë montojeni gjithnjë horizontalisht dhe vertikalisht;
2. Shponi vrima të thella 32mm në mur, për të fiksuar pllakën;
3. Vendosni upa te vrimat e saposhpuara;
4. Fiksojeni panelin e pasmë në mur me vida që shpojnë, që mund t'i gjeni të gatshme;
5. Sigurohuni që paneli i pasmë të jetë fiksuar mjaftueshëm për të përballuar peshën.

Vini re: Forma e pllakës montuese mund të jetë e ndryshme nga ajo më sipër, por metoda e instalimit është e ngjashme.

Shpimi me trapan në mur për vrimën e tubave

1. Shpojeni vrimën për tubin (φ 55) duke e anuar për nga poshtë me anën e jashtme.
2. Vendoseni mëngën mbrojtëse të tubit në vrimë për të shmangur dëmtimin e tubit lidhës dhe lidhjeve elektrike gjatë kalimit në vrimë.

⚠ Vrima duhet të qëndrojë e anuar tatëpjetë drejt pjesës së jashtme

Vini re: Mbajeni tubin e kullimit poshtë nga drejtimi i vrimës në mur, përndryshe do të ketë rrjedhje të ujit

Lidhjet elektrike---Njësia e brendshme

1. Hapni panelin ballor.
2. Hiqeni kapakun, siç tregohet në figurë (duke hequr vidën ose duke thyer grepat mbajtës).
3. Për lidhjet elektrike, shihni diagramin e qarkut në pjesën e djathtë të njësisë, poshtë panelit ballor.
4. Lidhni kabllo të klemikat, duke ndjekur numrat. Përdoreni përmasën e telit të përshtatshëm me portën e njësisë së brendshme elektrike (shihni emrin te njësia) dhe sipas të gjitha kushteve aktuale të kodit për sigurinë kombëtare.




⚠ Kabloja që lidhet me njësinë e brendshme dhe të jashtme duhet të jetë e përshtatshme për përdorim të jashtëm.

⚠ Priza duhet të jetë e aksesueshme edhe pasi pajisja të jetë instaluar, në mënyrë që të mund të hiqet nëse është e nevojshme.

⚠ Duhet të sigurohet tokëzimi i efektshëm.

⚠ Nëse kabloja dëmtohet, ajo duhet zëvendësuar nga një Qendër e autorizuar Shërbimi.

Vini re: (Sipas zgjedhjes) Telat mund të lidhen me PCB-në kryesore të njësisë së brendshme nga prodhuesi, sipas modelit pa terminal.





MANUALI I INSTALIMIT --Instalimi i njësisë së brendshme


Lidhja e tubave të gazit ftohës

Tubat mund të vendosen në 3 drejtime, siç tregohet te numrat në figurë. Kur tubi vendoset në drejtimin 1 ose 3, hapni një vrimë përgjatë brazdës së njësies së brendshme me një prerës. Vendosini tubat në drejtimin e vrimës në mur dhe lidhni tubat prej bakri, tubin e tharjes dhe kabllo të rrymës elektrike me ngjitës, në mënyrë që uji të rrjedhë lirisht.

- Mos e largoni kapakun nga tubi derisa ta lidhni, për të shmangur lagështirën ose pluhurat.
- Nëse tubi përkulet ose tërhiqet shumë shpesh, atëherë ai do të ngurtësohet. Mos e përkulni tubin më shumë se tre herë.
- Kur tubi i mbledhur zgjerohet, shtrijeni tubin duke e hapur butësisht, siç tregohet në figurë.



Jepini formë tubit lidhës




Shtrirja e tubit të përkulur



Çelësi për shtrëngim

Brenda Jashtë



Lidhësit duhet të lihen jashtë


Lidhjet me njësinë e brendshme

1. Largoni kapakun e tubit të njësies së brendshme (kontrolloni nëse brenda tij ka copëza).
2. Vendosni pjesën fundore dhe krijoni një flanxhë në fund të tubit lidhës.
3. Shtrëngojini lidhjet, duke përdorur dy çelësa shtrëngues në drejtime të ndryshme
4. Për gazrat ftohës R32/R290, lidhësit mekanikë duhet të lihen jashtë.


Tharja e ujit të kondensuar në njësinë e brendshme

Tharja e ujit të kondensuar në njësinë e brendshme është thelbësore për një instalim të suksesshëm.

1. Vendoseni zorrën për tharje poshtë tubave, duke mos krijuar përthime.
 2. Zorra për tharje duhet të përkulet poshtë për të ndihmuar tharjen.
 3. Mos e përkulni zorrën për tharje dhe mos e lini të shtrembëruar ose të përkulur dhe mos e futni pjesën e saj fundore për tharje lidhet me një zgjatim, sigurohuni që të jetë e izoluar gjatë kalimit në njësinë e brendshme.
 4. Nëse tubat instalohen në të djathtë, tubat, kabloja e rrymës elektrike dhe zorra për tharje duhet të izolohehen dhe të sigurohen në pjesën e pasme të njësies me një tub lidhës.
- 1) Futni lidhjen me tuba në slotin përkatës.
 - 2) Shtypeni lidhjen me tuba për ta bashkuar me bazën.



YES



NO


NO

MANUALI I INSTALIMIT---Instalimi i njësisë së brendshme

INSTALIMI I NJËSISË SË BRENDSHME

Pasi të keni lidhur tubin sipas udhëzimeve, instaloni kablrot lidhëse. Tani instaloni tubin e kullimit. Pas lidhjes, izolojeni tubin, kablrot dhe tubin e kullimit me një material izolues.

1. Vendosini në pozicionin e duhur tubat, kablrot dhe tubin e kullimit.
2. Izolojini bashkimet e tubave me material izolues, duke e siguruar me ngjitës shirit.
3. Futini tubat izolues, kablrot dhe tubin e kullimit përmes vrimës së murit dhe montojeni njësinë e brendshme mbi pjesën e sipërme të pllakës montuese në mënyrë të sigurt.
4. Shtypeni dhe shtypeni pjesën e poshtme të njësisë së brendshme fort pas pllakës montuese.




MANUALI I INSTALIMIT---Instalimi i njësisë së jashtme

- Njësia e jashtme duhet të jetë e instaluar mbi në mur solid dhe të sigurohet shumë mirë;
- Procedura e ardhshme duhet të vëzhgohet me kujdes përpara se të lidhen tubat dhe kablrot lidhëse: vendosni cili është pozicioni më i mirë mbi mur dhe lini hapësirë për ta bërë më të lehtë mirëmbajtjen e kondicionerit;
- Sigurojeni mbështetjen mbi mur duke përdorur upa, që i përshtaten llojit të murit;
- Përdorni një sasi të madhe upash, më shumë se zakonisht, për të mbajtur peshën dhe të shmangen tronditjet gjatë vendosjes, gjithashtu që të qëndrojnë të fiksuara në të njëjtin pozicion për vite me radhë, pa u liruuar;
- Njësia duhet të instalohet sipas rregulloreve kombëtare.

Kullimi i ujit të kondensuar në njësinë e jashtme (vetëm për modelet e pompave për ngrohje)

Uji i kondensuar dhe akulli i formuar në njësinë e jashtme gjatë ngrohjes mund të thahen përmes tubit të kullimit


1. Sigurojeni portën e kullimit në vrimën 25mm e vendosur në pjesën e njësisë, siç tregohet në figurë.
2. Lidhni portën e kullimit dhe tubin e kullimit.
Jini të vëmendshëm që uji të kullojë në një vend të përshtatshëm.



MANUALI I INSTALIMIT---Instalimi i njësisë së jashtme

LIDHJET ELEKTRIKE

1. Hiqeni dorezën në pllakën e djalhtë të njësisë së jashtme;
2. Lidhjeni kordën për lidhje elektrike me terminalin;
- Lidhja e kësaj njësie duhet të përshtatet me atë të njësisë së brendshme;
3. Fiksojeni kordën për lidhje elektrike me morsetën;
4. Kontrolloni nëse teli është fiksuar siç duhet;
5. Duhet të sigurohet tokëzimi i efektshëm;
6. Vendoseni dorezën në pozicionin e mëparshëm.




LIDHJA E TUBAVE

Zhvidhosni pjesën fundore të tubave, duke përdorur të njëjtat procedura, si ato për njësinë e brendshme.

Për të shmangur kullimin, tregohuni të vëmendshëm ndaj pikave të mëposhtme:

1. Shtrëngoni pjesët fundore, duke përdorur dy çelësa anglezë. Kini kujdes të mos dëmtoni tubat.
2. Nëse çelësi për shtrëngim nuk funksionon siç duhet, me shumë mundësi do të ketë rrjedhje. Por, edhe duke e shtrënguar më tepër sëç duhet do të ketë rrjedhje, pasi flanxha mund të dëmtohet.
3. Mënyra më e sigurt është që të përdoret edhe çelësi fiksues, edhe çelësi shtrëngues: në këtë rast përdorni tabelën në faqen 29.




SHKARKIMI

Ajri dhe lagështira e mbetur brenda qarkut të gazit ftohës mund të shkaktojë keqfunksionim të kompresorit. Pasi të kenë lidhur njësinë e jashtme dhe të brendshme, shkarkoni ajrin dhe lagështirën nga qarku i gazit ftohës, duke

Inspektimi i Presionit të Gazit Ftohës

Presioni i ulët i gazit ftohës R290 është 0.4-0.6 Mpa, dhe presioni i lartë është 1.5-2.0 Mpa; Presioni i ulët i gazit ftohës R32 është 0.8-1.2 Mpa, dhe presioni i lartë është 3.2-3.7 Mpa; Kjo nënkupton që sistemi i ftohjes ose gazit ftohës i një kondicioneri është në nivele jo normale atëherë kur shkalla e presionit të ulët ose të lartë e kompresorit të detektuar i tejkalon nivelet normale.





SHKARKIMI

Ajri dhe lagështira e mbetur brenda qarkut të gazit ftohës mund të shkaktojë keqfunksionim të kompresorit. Pasi të keni lidhur njësinë e jashtme dhe të brendshme, shkarkoni ajrin dhe lagështirën nga qarku i gazit ftohës, duke përdorur pompën e vakumit.

- (1) Zhvidhosini dhe hiqini kapakët nga valvulat me 2 kanale dhe 3 kanale.
- (2) Zhvidhosini dhe hiqini kapakun nga porta e shërbimit
- (3) Lidhjeni pompën e vakumit me portën e shërbimit.
- (4) Përdoreni pompën e vakumit për 10-15 minuta, derisa të jetë arritur vakumi absolut prej 10 mm Hg.
- (5) Kur pompa e vakumit të jetë ende në punë, mbylleni çelësin e presionit të ulët të lidhja e pompës së vakumit. Ndalojeni punën e pompës së vakumit.
- (6) Hapeni valvulën me 2 kanale duke e rrotulluar me 1/4 dhe pas 10 sekondash mbylleni. Kontrolloni të gjitha bashkimet për rrjedhje, duke përdorur sapun të lëngshëm ose një pajisje elektrike për detektimin e rrjedhjeve.
- (7) Rrotullojeni bazën e valvulës me 2 kanale dhe 3 kanale. Shkëputeni tubin e pompës së vakumit.
- (8) Zëvendësojini dhe shtrëngojini të gjithë kapakët e valvulave.

Skema e valvulës me 3 kanale



MANUALI I INSTALIMIT---testi i funksionimit

1. Izoloni erën, duke mbuluar pjesët bashkuese të njësisë së brendshme dhe fiksojeni me ngjitës izolues.
2. Fiksoni pjesën e tejzgjatur të kabllos që përcjell sinjal me tubin ose njësinë e jashtme.
3. Fiksojeni tubin në mur (pasi ta keni mbështjellë me ngjitës izolues), duke përdorur morseta ose vendosini në slote plastikë.
4. Mbylleni vrimën në mur përmes së cilës kalon tubi, në mënyrë që të mos hyjë as ajri dhe as uji.


Testi i njësisë së brendshme

- A punojnë normalisht butoni ON/OFF dhe FAN?
- A punon normalisht butoni MODE?
- A punojnë normalisht sensorët dhe butoni TIMER?
- A ndriçohet çdo dritë normalisht?
- A punon normalisht butoni për drejtimin e fletëve të ajrit?
- A kullon rregullisht uji i kondensuar?

Testi i njësisë së jashtme

- A bën pajisja zhurmë ose tronditje të pazakonshme gjatë kohës që është nderur?
- A i shqetëson fqinjët zhurma, fryrja e ajrit ose kullimi i ujit të kondensuar?
- A ka rrjedhje të gazit ftohës?

Vini re: kontrolluesi elektronik e lejon kompresorin që të fillojë punën vetëm tre minuta pasi rryma të ketë hyrë në sistem.



MODELI kapaciteti (Btu/h)	9k/12K	18k/24K
Gjatësia e tubit me ngarkesë standarde	5m	5m
Largësia maksimale ndërmjet njësisë së brendshme dhe të jashtme	25m	25m
Ngarkesa shtesë e gazit ftohës	15g/m	25g/m
(Filloni nga 5m)	10m	10m
Diferenca maksimale e nivelit ndërmjet njësisë së brendshme dhe të jashtme Lloji i gazit ftohës (1)	R32/R290	R32/R290

Referojuni të dhënave në etikën e ngjitur në njësinë e jashtme.

(2) Sasia e ngarkesës totale duhet të arrijë maksimumin sipas tabelës GG.1, në faqen 20.

ÇELËSI PËR SHTRËNGIMIN E KAPAKËVE MBROJTËS DHE LIDHJEN E FLANXHAVE



TUBI	ÇELËSI PËR SHTRËNGIM [N x m]	FORCA KORRESPONDUESE (me çelës shtrëngues 20cm)		ÇELËSI PËR SHTRËNGIM [N x m]
1/4 " (φ 6)	15 - 20	wrist strength	Pjesët fundore të portës së shërbimit	7 - 9
3/8 " (φ 9.52)	31 - 35	arm strength	Kapakët mbrojtës	25 - 30
1/2 " (φ 12)	35 - 45	arm strength		
5/8 " (φ 15.88)	75 - 80	arm strength		

SKEMA E LIDHJEVE

Skema e lidhjeve mund të jetë e ndryshme për modele të ndryshme. Ju lutemi, referojuni skemave të lidhjeve në njësinë e brendshme dhe të jashtme.

Te njësia e brendshme, skema e lidhjeve gjendet poshtë panelit ballor;

Te njësia e jashtme, skema e lidhjeve gjendet pas kapakut të dorezës së njësisë.



Vini re: Për disa modele, telat mund të lidhen me PCB-në kryesore të njësisë së brendshme nga prodhuesi, sipas modelit pa terminal.

MANUALI I INSTALIMIT---Informacion për instaluesin

SPECIFIKIMET PËR TELAT E KABLOVE

MODELI	kapaciteti (Btu/h)	5k	7k	9k	12k	15/18k	22/24k	28/30k/36k
		zona ndarëse						
Kabllot e rrymës elektrike	N	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14 H05RN-F	4.0mm ² AWG12
	L	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14 H05RN-F	4.0mm ² AWG12
	E	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² AWG18	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14 H05RN-F	4.0mm ² AWG12
Kabllot e furnizimit të lidhjeve	N	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²
	L	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²
	1	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ²	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²
	2	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²
	3	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²
	⊕	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²	0.75mm ²

LLOJI I INVERTERIT	MODELI	kapaciteti (Btu/h)	9k	12k	18/22k	24k
			zona ndarëse			
Kabllot e rrymës elektrike	N		1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14
	L		1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14
	E		1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.0mm ² (1.5mm ²) AWG18 (AWG16)	1.5mm ² AWG16	2.5mm ² AWG14
Kabllot e furnizimit të lidhjeve	N		1.0mm ² (1.5mm ²)	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²
	L		1.0mm ² (1.5mm ²)	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²
	1		1.0mm ² (1.5mm ²)	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²
	⊕		1.0mm ² (1.5mm ²)	1.0mm ² (1.5mm ²)	1.5mm ²	0.75mm ²

220V 7K, 9K, 12K 15K, 16K, 18K, 22K, 24K, 30K parametri i siguresës së njësisë së brendshme të kondicionerit është 50T, 3.15A
 110V 7K, 9K 12k parametri i siguresës së njësisë së brendshme të kondicionerit është 50T, 3.15A,
 125V 7K, 9K, 12K parametri i siguresës së njësisë së jashtme të kondicionerit është 61T, 15A
 250V 18K, 22K, 24K parametri i siguresës së njësisë së jashtme të kondicionerit është 65TS, 25A

MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja periodike e kondicionerit është thelbësore për mbajtjen e tij në mënyrë të efektshme. Përpara procesit të mirëmbajtjes, shkëputeni rrymën elektrike, duke hequr spinën nga priza.

NJËSIA E BRENDSHME

FILTRAT KUNDËR PLUHURAVE

1. Hapni panelin ballor, duke ndjekur drejtimin e shigjetës.
2. Ngrijeni panelin ballor me njërin dorë dhe nxirreni filtrin e ajrit me dorën tjetër.
3. Pastrojeni filtrin me ujë; nëse filtri është i mbuluar me vaj mund të lahet me ujë të ngrohtë (pa i kaluar 45°C). Lëreni të thatet në një vend të freskët dhe të thatë.
4. Ngrijeni panelin ballor me njërin dorë dhe futni filtrin e ajrit me dorën tjetër.
5. Mbylleni.

Filtri elektrostatik dhe filtri kundër aromave të padëshiruara (nëse instalohet) nuk mund të lahet ose të rigjenerohet dhe duhet zëvendësuar me filtra të rinj çdo 6 muaj.

PASTRIMI I SHKËMBYESIT TË NGROHTËSISË

1. Hapni panelin ballor të njësisë dhe më pas shkëputeni nga kapëset mbajtëse për ta bërë pastrimin më të lehtë.
2. Pastrojeni njësinë e brendshme me një rrobë të lagur me ujë (temperatura jo më shumë se 40°C) dhe sapun. Mos përdorni asnjëherë detergjentë.
3. Nëse njësia e jashtme është e bllokuar, largoni gjethet dhe mbetjet dhe largojeni pluhurin me tubin e ajrit ose me pak ujë.

PROCESI PËRFUNDIMTAR I MIRËMBAJTJES

1. Shkëputni çelësin automatik ose spinën;
2. Pastroni dhe zëvendësoni filtrat;
3. Në ditët me diell lëreni kondicionerin që të punojë me ventilim për disa orë, në mënyrë që pjesa e brendshme e njësisë të thatet plotësisht.

NDËRRIMI I BATERIVE

Kur: • Nuk do të dëgjoni sinjal zanor nga njësia e brendshme.


- LCD-ja nuk punon.

Si: • Hiqni kapakun në pjesën e pasme.


- Vendosini bateritë e reja sipas simboleve + dhe -.

Kujdes: Përdorni vetëm bateri të reja. Hiqini bateritë nga pulti i komandimit kur kondicioneri nuk është punë.

PARALAJMËRIM! Mos i hidhni bateritë te koshi i mbeturinave të zakonshme, ato duhet të asgjësohen te koshat e veçantë, që ndodhen në pikat e mbledhjes së mbeturinave.



filtri kundër pluhurave



TROUBLESHOOTING

KEQFUNKSIONIMI	SHKAQET E MUNDSHME	
Pajisja nuk funksionon	Nuk ka rrymë elektrike/spina është hequr nga priza	
	Motori i ventilatorit të njësisë së brendshme/të jashtme është dëmtuar	
	Kompresori termomagnetik i qarkut është me defekt	
	Pajisjet mbrojtëse ose siguresat janë me defekt	
	Lidhje të shkëputura ose spina është gjysmë e hequr nga priza	
	Ndonjëherë ndalon punën për të mbrojtur pajisjen	
	Voltazhi më i ulët ose më i lartë sesa shkalla e duhur	
	Funksioni TIMER-ON është aktiv	
Bordi i kontrollit elektronik është i dëmtuar		
Aromë e çuditshme	Filtri i ajrit është i papastër	
Zhurme uji që rrjedh	Rrjedhje e lëngut në qarkulluesin e gazit ftohës	
Nga pajisja e ajrit del tym	Kjo ndodh kur ajri i dhomës bëhet shumë i ftohtë, për shembull në regjimin “COOLING” ose “DEHUMIDIFYING/DRY”	
Dëgjohet një zhurmë e çuditshme	Kjo zhurmë shkaktohet nga zgjerimi ose kontraktimi i panelit ballor, për shkak të ndryshimeve të temperaturës dhe nuk shfaq asnjë problem	
Rrymë ajri e pamjaftueshme, ose e ngrohtë, ose e ftohtë	Temperaturë e papërshtatshme	
	Tabli i futjes ose daljes së ajrit në njësinë e brendshme ose të jashtme është bllokuar	
	Filtri i ajrit është bllokuar	
	Shpejtësia e ventilatorit është shumë e ulët	
	Në dhomë gjenden burime të tjera nxehtësie	
Pajisja nuk i përgjigjet komandave	Nuk ka gaz ftohës	
	Pulti i komandimit nuk është mjaftueshëm afër me njësinë e brendshme	
	Bateria e pultit të komandimit mund të ketë mbaruar	
	Pengesa ndërmjet pultit të komandimit dhe marrësit të sinjalit në njësinë e brendshme	
Ekranin është i fikur	Funksioni LED është aktiv	
	Nuk ka rrymë elektrike	
Fikeni menjëherë kondicionerin dhe ndërpriteni furnizimin me energji elektrike, në rast se:		
Bën zhurma të çuditshme gjatë kohës që është ndezur		
Bordi i kontrollit elektronik është me defekt		
Siguresat ose çelësat janë me defekt		
Brenda pajisjes futet ujë ose objekte		
Kabllot ose spinat mbinxehen		
Nga pajisja dalin aroma shpuese		
NË EKSPAN SHFAQEN SINJALE QË TREGOJNË GABIME		
Në raste gabimi, në ekranin e njësisë së brendshme do të shfaqen kode gabimi, si më poshtë:		
	Drita e funksionit RUN	Përshkrimi i gabimit
E1	pulson një herë	Sensori i temperaturës së brendshme është me defekt
E2	pulson dy herë	Sensori i temperaturës së tubit të brendshëm është me defekt
E6	pulson gjashtë herë	Keqfunksionimi i motorit të ventilatorit të brendshëm

BRUNO**AIR**[®]
POWERED BY TCL